

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 20.04.2017]

Për: Operatorin Ekonomik "Shkelqimi 07" shpk

Procedura e prokurimit: "Tender i Hapur" me objekt: "Rikonstruksioni i rrugës Gradishtë – Spolatë, segmenti Spolatë e vogël – Spolatë e madhe".

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksioni i rrugës Gradishtë – Spolatë, segmenti Spolatë e vogël – Spolatë e madhe".

Kohëzgjatja: brenda 4 muajsh nga data e fillimit të punimeve.

Fondi limit: 45,175,899 (dyzet e pesë milion njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH.

Fondi i akorduar për vitin 2017 është 9,166,667 (nëntë milion njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 05.04.2017.

Publikimet më parshme (nëse zbatohet): Nuk kapatur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	"SHKELQIMI 07" SHPK	29,523,980
2	"MELA" SHPK	35,000,000
3	"ELIRA" SHPK	37,613,978
4	"BE - IS" SHPK	38,465,190
5	"SHENDELLI" SHPK	40,808,350
6	"EURONDERTIM MK" SHPK	44,080,520
7	"STERKAJ" SHPK	44,792,381

Pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Mela” shpk (35%) dhe “Albshpresa” shpk (65%) per arsye se:

Shoqeria “Mela” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier hidroteknik, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punime hidroteknike, per kryerjen e te cilave ky specialitet eshte i domosdoshem.

Shoqeria “Mela” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier topograf, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punime hidroteknike dhe punime rrugore, per kryerjen e te cilave ky specialitet eshte i domosdoshem.

Shoqeria “Mela” shpk nuk ploteson piken 2.3.6 per kualifikim lidhur me pikat e nevojshme te licenses pasi ka marre persiper punime shtresash rrugore dhe nuk ka piken e licenses NS18 (punime topogjeodezike).

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

Te skualifikoje shoqerine “Be - Is” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Durres, Librazhd dhe Vlore nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore. Per rrjedhoje edhe deklarata e paraqitur ne perputhje me kriterin 2.2.5 per kualifikim rezulton te jete e rreme.

Te skualifikoje shoqerine “Shendelli” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, si dhe puneve te ngjashme te deklaruar ne tender rezulton se ka kryer aktivitet gjate vitit 2016 ne Divjake dhe Ballsh dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore. Per rrjedhoje edhe deklarata e paraqitur ne perputhje me kriterin 2.2.5 per kualifikim rezulton te jete e rreme.

Te skualifikoje shoqerine “Eurondertim MK” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.3.6 per kualifikim lidhur me pikat e nevojshme te licenses pasi nuk disponon piken e licenses N.P – 11. A (Ndërtim për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë).

Nuk ploteson Kerkesen per Kualifikim lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve per muajin shkurt 2017, muaj i maturuar ne daten e hapjes se ofertave.

Nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi te gjitha punimet e paraqitura jane te periudhes 2007 – 20011, jashte afatit te kerkuar tre vjecar.

Te skualifikoje shoqerine “Sterkaj” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi puna e paraqitur eshte implant i trajtimit te ujrave te zeza dhe nuk mund te konsiderohet i ngjashem. Per kete objekt nuk ka paraqitur formularin e vleresimit dhe faturat tatimore.

Duke iu referuar procedurës së lart përmendur, informojmë Operatorin ekonomik “Shkelqimi 07” shpkse oferta e paraqitur, me vlerë 29.523.980 (nëzet e nentemilion e pesëqind e njëzet e tremije e nentëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor:

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania
- Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)
- Fax: 00355 4 2 234 885

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 12.04.2017.

Per procedure nuk jane paraqitur ankime

